

NIKOLETA KALLDRËMXHIU

VEÇANËSIA E GJUHËS FËMINORE

Gjuha fëminore ka **karakter evolutiv** që duket si në stadet natyrale të zhvillimit të saj dhe në mësimin e drejtuar të gjuhës që në Shqipëri fillon që në moshën 3 vjeçare. Pa dashur të evidentojmë tipare që paraqesin faza të ndryshme të zhvillimit ky mëtin modest synon të sjellë disa veçanti të gjuhës fëminore. Ai mbështetet në vrojtimin e një ditari personal si dhe në tekstet mësimore të kësaj moshe. Vrojtimi i gjuhës së fëmijëve u ka dhënë shpesh dorë studiuesve për t’iu qasur një teorie për përvetësimin të gjuhës dhe mësuesit të gjuhës amtare për mësimin e gjuhës së shkruar. Ai ka për qëllim që të sjellë veçori të gjuhës fëminore të fëmijët shqiptarë, me vlerë teorike dhe praktike.

Gjuha fëminore është **referuese** pse edhe të rriturit i referohen për arsyet që përmendëm më sipër, edhe të vegjlit në të shumtën e rasteve, si bazë zgjedhin atë që quhet të folurit mëmësor¹. Në të vërtetë mendohet se e folura e baballarëve shërben si urë ndërmjet rregullave të holla të nënës dhe gjuhës komplekse dhe të çrregullt të botës së jashtme. Edhe për shoqërinë shqiptare jemi të detyruar të pranojmë, po edhe të pohojmë, se krahas modelit fillestar sipas “gjuhës së nënës”, mund të veprojmë, ku më pak e ku më shumë, edhe modeli i bigëzuar ku luan rol “gjuha e babës”. Në gjuhën e fëmijës² dhe të të riut nuk janë pa ndikim dhe mjedisi farefisnor e shoqëror ku ai lind, rritet e formohet në rrjedhë të moteve. Zgjerimi i fondit të fjalëve ndryshe nga të rriturit është një proces që zhvillohet me shpejtësi dhe ka varësi sociale, kulturore dhe, siç do ta argumentojmë më poshtë, varet nga edukimi. Të nxënit dhe krijimi i kategorive semantike të fëmijët ndihmohet nga modelimi i prindërve. **Gjuha mbështet mbi modelet e mbi të gjitha ka karakter kreativ.**

- *Realizon **parametra në nënsistemet gjuhësore.*** Përveç tabelës përmbledhëse të zhvillimit gjuhësor që i paraqit këto parametra, kemi dhënë disa shembuj që i shërbejnë edhe zbulimit të disa fakteve gjuhësore. Gjuha është një sistem kompleks dhe dinamik i simboleve konvencionale që përdoret në forma të ndryshme për mendimin dhe komunikimin.

Procesi fonologjik deri te parashkollorët është një moment i rëndësishëm për të sjellë të dhëna për një teori për përvetësimin e gjuhës. Besoj se zhvillimi i kuptimit bëhet si në mënyrë lineare ashtu edhe në mënyrë paradigmatiske.

Rënia e bashkëtingëllores nistore

ota ~ rrota

uk ~ nuk

ugulloj ~ rregulloj

¹ *Psikologjia e fëmijës*, Tiranë, 2007, f. 413.

² Gj. Shkurtaaj, *Sociolinguistikë e shqipes*, Tiranë, 2002, f. 93.

Rënia e zanores nistore

otopejant ~ altoparlant a) asimilim të zanores nistore sipas zanores së dytë në trup të fjalës. b) rënia e **r** alveodhëmbore dhe **l** qiellzore në velaren **j**

Rënia e rrokjes nistore

teresante ~ interesante

Asimilime dhe rënie tingujsh

Fodavia ~fotografia

Shko~shiko

Rënie dhe shtim tingujsh njëkohësisht

pastojinë ~ pastrojnë

motematikë ~ matematikë

Kompyter ~ kompjuter nga një **ju** e prapme në një **y** të përparme

Ndërrimet

Strena~streha një **h** glotale në **n** alveo-qiellzore **h** → **n**. Mbështetur në veçoritë nyjetimore të bashkëtingëlloreve të shqipes, nga pikëpamja e radhës fonologjike fëmija i realizon më përpara se **ç** i realizon i rrituri.

p dybuzore në një **k** velare. **p** ⇄ **k** Në këtë rast lidhur me **rradhën**

Krevaz~prevaz **p** dybuzore në një **k** velare. **p** → **k** Në këtë rast lidhur me radhën fonologjike, fëmija e ka shtyrë prapa radhën fonologjike duke e realizuar fjalën me një **k** velare.

Në këtë grup shndërrimesh mund të futet dhe *kusetë~pusetë*

Mujt ~ muaj një diftong **ua** në një **u** e prapme dhe një shtesë të një tingulli fundor.

Ilivi~Iliri, qirivi ~ qiriri një **r** alveodhëmbore në një **v** buzore dhëmbore **r** → **v** radha fonologjike shkon prapa

Minë ~ mirë një **r** alveodhëmbore në një **n** **r** → **n** i ngjan një rotacizmi

Jyej~juen~lyej; Laps ~japs **Lule ~ jule** një **l** nistore në **j** pra një qiellzorizim **l** → **j**

Krahaso: *golë ~ gojë, bilë ~ bijë*, është një shembull një palatalizim i **l**-së deri në spirantizim në **j**.

Fotë ~thotë një **th** ndërthëmbore në një **f** buzore dhëmbore **f**→ **th**

Përtëkalle ~ portokalle një **o** e prapme kthehet në një **ë** qendrore

Motmëtikë ~matematikë një **a** e prapme e hapur në një **ë** qendrore, gjysmë e hapur

Kundestar ~ kujdestar **n** alveodhëmbore në një **j** qiellzore prapa **n** → **j**

Sonde ~ sonte **t** e shurdhët në **d** të zëshme **d** → **t**

Karrosën ~ karrocën një mbylltore **c** në një shtegore **s** **s** → **c**

dishka~diçka **ç** një mbylltore në një **sh** shtegore **ç** → **sh**

Kemi jo vetëm ndryshim në radhë, por edhe në seri

vëmbi~dhëmbi, vurata~dhurata ~ një ndërthëmbore **dh** në një **v** buzore dhëmbore **v** → **dh** është realizuar një radhë fonologjike para

dymerik ~numerik **d** kthehet në një **n** hundore për analogji me numerorin **dy**

Shitim tingujsh

Do loz ~do lozi

presi ~ pres

Ne ~ neve

Shohim se tingujt / fonema që shprehen me bashkëtingëlloret dyshe, janë zhvilluar më vonë dhe femija ka tendencë të realizojë të përvetësorë të parat, buzoret, dentalet pastaj alveolaret dhe qiellzoret.

Edhe në planin fonetik gjuha e fëmijëve priret drejt thjeshtimit.

Duke ndjekur këtë linjë dhe duke vërejtur strukturën e fjalës krahasuar me fjalë të afërta, ne i shtojmë një rrugë tjetër studimit të lindjes dhe zhvillimit të kuptimit dhe afërsisë kuptimore midis fjalëve.

Ndërrimet fonetike me vlerë gramatikore

Kreativiteti është gjithmonë i drejtuar nga rregullat. Kjo do të thotë që në procesin e përvetësimit të gjuhës, i duhet që prej fakteve të ligjërimit të cilave u ekspozohet, të abstrahojë parimet e përgjithshme të formimit, interpretimit të një sistemi të përshtatshëm rregullash sintaksore, morfologjike, fonologjike dhe semantike. Pra kreativiteti ynë në përdorimin e gjuhës, ndryshe nga liria dhe kontrolli i stimulit, shfaqet brenda kufijve të vënë nga rregullat e sistemit gjuhësor.

Vdeka ~ vdiqa nga një *i* e mbyllur në një *e* gjysmë të mbyllur rast ku për analogji nga tema foljore ose emërore ose nga mbaresat niset për të formuar me analogji trajtën përkatëse.

Turk ~ turq turk për shum. turq

Ktove~ktyre një **r** alveodhëmbore **v** buzore dhëmbore para

Derat~dyert një diftong **ye** në zanoren **a** e prapme në zbatimin e rregullës së numrit shumës (dy) dera për (dy) dyer

Shuj ~shuaj një diftong **ua** në një **u** të prapme

Shkruj ~shkruaj

Rastet e shmangieve, *lozi~ loz* *niset nga veta e tretë njëjës etj. mund të argumentohen pikërisht si shembuj të analogjisë.

Zbatim i rregullës së vetës së tretë. Deri në këtë moment në vend të *unë loza* femija përdor vetën e tretë *Pati lozi*. Në këtë mënyrë ai zgjedh këtë model analogjik. Shfaqja e vetës së tretë është mënyrë që shfaqet rëndom në të folurin feminar.

Apo *unë vdeka* në vend të *unë vdes sërish* i drejtohet rregullës së formimit të pjesores. Shumësi i emrave: *kala~kuaj, dora~duar, dera~dyer* tonë në gjedhen prodhuese të shumësit me **-a**.

Ndryshimet historike janë ato që përftohen më me vonesë, tregues i kohës që i është dashur të prodhohet një fakt gjuhësor i caktuar. Kjo vihet re në formimin e kohëve në foljet e çrregullta (apofonia dhe metafoia) si *marr, flas, vdes* etj.

Formimi i përemrave pronorë si pronorët: *dhëmbët e mua~ dhëmbët e mi ndjek* gjedhen e përemrave vetorë në dhanore dhe kallëzore të pronorët si dhe afërsia me vetën e dytë shumës e tua me mua. Formimi i vetës së parë duket se është më i vonë.

Trajtat e shkurtra të bashkuara *na dha ~ma dha, na jep~na e jep~ma, na jap~ma jep*, sipas gjedhes fjalëformuese të shumësit në vend të njëjësit.

Një rast tjetër është mungesa e nyjës për formimin e rasës gjinore, si p.sh *makina zhavorit ~ makina e zhavorit*, sipas modelit të mbiemrave të panyjshëm si *makina interesante*.

Zëvendësimin pothuaj në të gjitha rastet e parafjalës *në me më* ose *me me*, p.sh. *vete më Tiranë ~ vete në Tiranë, kërkoj me julishte ~ kërkoj në lulishte*

Si shumësi me *-a* ashtu edhe koha e shkuar tregojnë se shkaku i gabimeve është zbatimi i rregullës që fëmija e nxjerr nga rregulla që njeh më mirë ose më të gjerë. Këto rregulla që drejtojnë aftësinë gjuhësore të folësit janë pjesë e rëndësishme e gramatikës së tij.

Përvetësimi i tingujve të fëmija ka mbaruar aty nga mosha 8 -10 vjeçare ku ai e ka të lehtë të kapë nuancat e holla të tingujve të gjuhës amtare, por edhe të një gjuhe të huaj nëse mëson një të tillë, vihen re një sërë gabimesh edhe në klasën e tretë e të katërt, si p.sh.: përdorimi pa vend i ë-së, të togut të zanoreve **ua**, të togut të zanoreve **ue**, të formave me **va**, në grupet e bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng** etj., ruajtja e **h** hundore ose jofundore, përdorimi jo i drejtë i, **rr, th, sh** etj., këmbimi jo i drejtë **ll** për **dh**, i **r** për **rr** si dhe përdorimi jo i drejtë i nyjave.

Duke vazhduar më tej me sintaksën shohim se thëniet që ata prodhojnë mund të jenë ose jo në përputhje me rregullat e kësaj të fundit p.sh. *S'do ngrihem ditë për ditë natën ~ s'do ngrihem çdo natë; ça duket si figure ~ çfarë ka në figurë; ka shumë kohë që zh s'është marr shkronjë e re ~ do shumë kohë që zh të merret shkronjë e re; nuse e bukur me një çift~nuse e bukur me një burrë*. Sipas Çomskit gramatika e një gjuhe duhet të "gjenerojë të gjitha vargjet gramatikore që nuk janë fjali të saj". Shembulli i mësipërm tregon për mungesën e sintetizmit në performancën e një 7 vjeçari, që mund të zëvendësohet me togfjalëshin *çdo natë*. Natyrisht edhe gjenerimi sintaksor i referohet modelit të njohur (të njohur më mirë) sintaksor dhe gabimi rrjedh jo nga perceptimi, por nga koncepti.

Rregullat semantike të lidhjes së togfjalëshave të lirë në fjali, vihen re kur fëmija mëson fjalë të reja në gjuhë të huaj, kur e ka mësuar amtaren. Shpesh, për fjalët që i vendos pranë njëra-tjetrës ai pyet: A kanë kuptim? Në mënyrë intuitive ai kërkon bashkëlidhjen semantike të fjalëve.

Kur flasim për **funksionin metalinguistik** të gjuhës, kujtojmë se fëmijët kuptojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

Vitet e shkollës janë një bum përsa i përket zhvillimit të leksikut, gjë që tregon se gjuha është një veprimtari shoqërore, e zhvilluar prej rregullave, pasi edhe puna e edukatorëve është një veprimtari tashmë e kualifikuar.. Funkcioni metalinguistik verifikon dhe plotëson me shenja kodin fëminor, me qëllim që fëmija të kuptojë mesazhin. Krahasuar me të rriturit operacionet metalinguistike janë të zakonshme dhe më të shpeshta te fëmija si gjatë mësimi të një gjuhe të huaj ose të gjuhës amtare.³

³ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, f 29.

Veçanësia e gjuhës feminare

Po për gjuhën e figurshme? Një nxënës gjithashtu zhvillon gjuhën figurative, që e lejon atë ta përdorë gjuhën në mënyrë kreative. Përdorimi i gjuhës së figurshme kërkon imagjinatën dhe shprehjen indirekte më fort sesa komunikimin e drejtpërdrejtë, për të emocionuar a shprehur në mënyrë ekspresive. Tipi kryesor i figuracionit të fëmija përfshin idiomat, metaforat, krahasimet dhe proverbat.

Një parashkollor përdor mjete të tilla. H. Gardner dhe Winner (1979) kanë dhënë këta shembuj: Një tullac është përshkruar si kokëzbathur; një semafor si kallam sheqeri; ndërsa djali im në moshën katër vjeçare përdor *pastërti magjike* për *manikyr*.

Mjetet e para të figurshme mbështeten kryesisht në ngjashmërinë fizike apo në ngjashmërinë e përdorimit a të funksionit. Duken të jenë një zgjatim apo shoqëruese të lojërave simbolike. (H. Gardner, 1974; Gentner; 1977). Në këto shprehje, pretendimi sugjerohet shpesh. Përdorimi i gjuhës figurative të fëmija shpesh buron nga ajo që fëmija nuk di mjaftueshëm dhe jo nga kreativiteti (Hakes, 1982, f. 196). Metafora bëhet më pak e përdorshme në ligjërimin e zakonshëm pas moshës 6 vjeçare. Dy arsyt themelore për këtë rënie janë, e para, se fëmija ka një fjalor bazë, që ka pak gjasa të shtrihet te fjalët e reja; dhe e dyta, edukimi shkollor lë pak vend për kreativitet. (H. Gardner & Winner, 1979).

Figurat e tjera të mbetura janë më për të rritur. *Sa shumë i bukur ky emër* është një shembull i vetëm i shumë rasteve kur fëmija 7 vjeçar përdor një sintaksë jo të rregullt.

Me sa duket kjo rënie në figuracion vjen për shkak të arsimit në shkollë. E teksa figuracioni duket se bie, ajo që rritet është shkalla e kuptimit. Interpretimi i figuracionit ngelet ajo anë me të cilën zhvillohet kompetenca e fëmijës. Ai paraqitet i vështirë ose i keqinterpretuar në kontrast me një 8-9 vjeçar që fillon ta vlerësojë këtë proces. Ai vazhdon ta interpretojë, sepse nuk e kupton dimensionin psikologjik. Keqinterpretohet metafora, p.sh. *Ani është e ftohtë* interpretohet si *Ani jeton në pol*. Proverbat përfaqësojnë tipin e fundit të të folurit të figurshëm. Përmbajtja e tyre është shpesh e vështirë për t'u kuptuar nga nxënësit e ciklit fillor, p.sh: *e bëri qimen tra ~ e zmadhoi, i hap zemrën ~ tregohem i sinqertë*, ose së paku kanë nevojë për shpjegimin e të rriturve.

Interpretimi i tyre, siç është në rastin e metaforave, është shpesh i drejtpërdrejtë. Një zhvillim i tillë ndodh në adoleshencë. Gjëgjëzat që mbështeten në krahasim janë format më të preferuara për fëmijët dhe argëtuese për ta. Bile mësimi i tyre është një argument me anë të të cilit edukimi është edhe një proces që zhvillon imagjinatën. Natyra ritmike e tyre i bën ato lehtësisht të ngulitshme në mend. Po kështu poezitë e thjeshta mbështeten në katakrezat dhe krahasimet: *yjet si zjarr* etj., që janë forma të thjeshta komunikimi dhe janë shembuj të nxitjes së imagjinatës.

Interpretimi i drejtpërdrejtë dhe figurativ zhvillohet paralelisht (Glas, 1983; Swinney & Cutler, 1979). Kuptimi figurativ depozitohet në leksikonin e fëmijës si një fjalë e vetme. Si ndodh procesi i njohjes së drejtpërdrejtë dhe asaj të figurshme

nuk është i qartë (Fraser, 1974; Heringer, 1976)⁴. Shqisat luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces.

Përdorimi i fjalëve ndjesore, që lidhen me perceptimin i shërbejnë përshkrimit zhvillojnë njëkohësisht si komunikimin e drejtpërdrejtë ashtu edhe atë të figurshëm.

Në moshën 6-8 vjeçare ata përftojnë ironinë dhe sarkazmën, e cila kërkon që fëmija të njohë dhe nënshtresimet sociale dhe gjuhësore.

Perioda e shkollës e përshkruar nga Piaget si periudha e operacioneve më konkrete, ku fëmija orientohet drejt reales dhe të drejtpërdrejtës.

Përdorimi i shpeshtë i fjalorit aktiv, kuptimin e së cilëve ai e sjell me njëfarë përafërsie dhe fillon të njihen mirë, nguliten dhe përdoren lirshëm në komunikim. Është e qartë se fjalori pasiv, ato që ai kupton është më i madh. Të rriturit nuk marrin asnjë trajnim të veçantë për mënyrën se si duhet të vijë gjuha te fëmijët e kjo së paku deri në stadet parashkollë, ku nxitja e të mësuarit analitik -sintetik sjell një bum të vërtetë në edukimin e tyre gjuhësor.

- **Zgjerimi dhe ekonomia gjuhësore është karakteristikë e gjuhës fëmimore.** Përcaktimi i fushave leksikore në harkun kohor deri në 12 vjeç, do të sillte universalitetin e botës që fillon e ndërtohet me fjalët e përgjithshme, të specializuara e terminologjike. Jo vetëm në fjalë por edhe në togfjalësja të lirë e terminologjike shihet zhvillimi i një procesi gjuhësor nga e drejtpërdrejta te e figurshmja, nga konkretja te abstraktja. Zbërthimi i strukturës semantike të fjalës e cila bëhet në bazë të përbërjes, formës, tiparit dhe ndërtimit, të lëndës, pëlqimit dhe motivimit, ngjyrës, klasës më të afërt nuk është gjë tjetër veçse tregues i realjes të cilat zbërthejnë së bashku me leksematikën e fjalës, strukturën semantike të saj. I tillë zhvillimi i gjuhës fëmimore në këtë stad karakterizohet nga parimi semantik (sipas një tematike të caktuar në minimum leksikor futen fjalët që shprehin koncepte të rëndësishme që hasen në tekstet mësimore). Të drejtohem nga koncepti i Humboldt, sipas të cilit kompetenca ishte një sistem i nëntëshëm, procesi gjenerues.⁵ Humboldti e shihte gjuhën si një energje (proces dinamik, një energji) dhe jo si ergon (produkt historik).

Ekonomia gjuhësore duket në zgjedhjet e lira të një minimumi fjalësh që sigurojnë më tepër kombinime, me të cilat formohen më shumë togfjalësja të tillë si qarko emrat, bëj vjershë, bëj pazarin, bëj piktura, ndaj fjalinë, ndaj rreshtin, ndaj numrin etj. Përsa i përket shkallës së lidhjes gramatikore të fjalëve në fjali, vëmë re se foljet lidhen më lirshëm me fjalë të tjera, ndërsa emrat dalin më pak të lidhur në fjali dhe në funksione të ndryshme. Shkalla e lidhjeve gramatikore e cila mund ta vështirësojë ose lehtësojë përvetësimin e fjalorit, në fazat e para të përvetësimit të gjuhës dallohet nga prirje personale e shoqërore.

Por, duhet shënuar se kjo moshë dallon për një njohje të ulët të fjalës polisemantike, por në kufijtë e minimumit leksikor ato ndahen në fjalë njëkuptimshme. Fushat tematike më të përdorura janë ato të **komunikimit**

⁴ E. Robert, Jr. Owens, *Language development*, f. 200.

⁵ N. Chomsky, vep, cit., f. 4.

Veçanësia e gjuhës fëminore

gjuhësor, që del për të zbërthyer fjalë, përkufizime e koncepte, për të bashkëlidhur gjuhësisht karakteristikat ndërlëndore, siç vihet re edhe në tekstet e sotme të matematikës e të gjuhës, që sjellin kategori logjike të kohës, të probabilitetit, bashkësisë etj.

Fusha të tjera: fusha e koncepteve të njësisë, fusha leksikore e koncepteve shoqërore, estetike e artistike, fusha mbi njeriun, fusha e perceptimeve (shijet, erërat, aromat, tingujt, ngjyra: lëvizje, forma, masa etj.), tregojnë larminë e botës fëminore dhe prirjen në formim të saj.

Evidentimi i këtyre veçorive që zbulojnë tipare të idiolektit në ligjërimin⁶ fëminor shqiptar, i jep përparësi njohjes dhe mësimit sa më të mirë të gjuhës amtare.

⁶ Djali dhe nipi im 10 dhe 6 vjeçar.